

20110170396

**L I G J**  
**PËR NGARKIM TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË FONDIN MONETAR**  
**NDËRKOMBËTAR ME LINJË KREDITORE PARAKUJDESËSE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet në Fondin Monetar Ndërkombëtar me linjë kreditore parakujdesëse, në shumë prej 413 400 000 të drejta speciale për tërheqje (600% nga kuota), të dedikuar për mbështetjen e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 2

Afati i pagesës së çdo shume të tërhequr të linjës kreditore nga neni 1 i këtij ligji, është pesë vjet e tre muaj me grejs periudhë të përfshirë prej tre vitesh e tre muaj, përkatësisht çdo tërheqje e linjës kreditore do të paguhet në tetë këste të barabarta tremujore, duke filluar nga tremujori i dytë i vitit të katërt nga data e tërheqjes.

Në shumën e tërhequr të linjës kreditore deri në 300% nga kuota, do të zbatohet shkallë e kamatës në lartësi të shkallës së shpenzimeve, që e përcakton Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Në shumën e tërhequr mbi 300% nga kuota, do të zbatohet shkallë e kamatës në lartësi të shkallës së shpenzimeve që e përcakton Fondi Monetar Ndërkombëtar, e rritur për 2%.

Për çdo tërheqje të realizuar, Fondit Monetar Ndërkombëtar do t'i paguhet shpenzim për shërbime në lartësi prej 0,5%.

Në shumën e mjeteve të patërhqura, do të paguhet provizion vjetor në lartësi prej 0,15% në 200% të para nga kuota dhe 0,3% në shumën e patërhqur mbi 200% nga kuota.

Provizioni i paguar i mjeteve të patërhqura do t'i refundohet Republikës së Maqedonisë, deri në shumën e tërheqjeve të realizuara.

Neni 3

Autorizohet Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë në cilësinë e agjentit fiskal të Republikës së Maqedonisë dhe depozitarit të mjeteve monetare të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që t'i pranojë dhe t'i transferojë mjetet nga neni 1 i këtij ligji në llogari të posaçme të Ministrisë së Financave, që për këtë qëllim do të hapet në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë.

Neni 4

Mjetet e linjës kreditore nga neni 1 i këtij ligji, do të shfrytëzohen për mbështetjen e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 5

Republika e Maqedonisë linjën kreditore nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ministria e Financave dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, do të lidhin Marrëveshje për rregullimin e shfrytëzimit dhe kthimit të mjeteve nga nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".